

PROGRAMI I CIKLIT TË PARË TË STUDIMIT BACHELOR NË “SHKENCA TË REHABILITIMIT”

Programi i studimit Bachelor në “Shkenca të Rehabilitimit”, i ofruar nga Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit në Universitetin e Sporteve të Tiranës, **u hap për herë të parë në vitin akademik 2020–2021, me Urdhrin nr. 245, datë 22.07.2020, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.**

Ky program synon të ofrojë një formim të integruar akademik dhe profesional në fushën e rehabilitimit, duke kombinuar njohuritë bazë shkencore me përgatitjen teorike, praktike dhe klinike.

Programi zhvillon njohuritë dhe kompetencat e studentëve në fushat e fizioterapisë, rehabilitimit, shkencave biomjekësore dhe të lëvizjes, duke i përgatitur për të kuptuar proceset e vlerësimit, parandalimit dhe rehabilitimit të çrregullimeve funksionale dhe për të kontribuar në përmirësimin e shëndetit dhe cilësisë së jetës.

Nëpërmjet formimit teorik, praktik dhe klinik, studentët njihen me parimet bashkëkohore të rehabilitimit dhe zhvillojnë aftësi për vlerësimin funksional, ndërhyrjen rehabilituese, promovimin e shëndetit dhe bashkëpunimin me profesionistë të fushave të ndryshme të kujdesit shëndetësor.

Programi krijon një bazë të qëndrueshme akademike dhe profesionale për vijimin e studimeve në ciklin e dytë dhe për zhvillimin e mëtejshëm profesional në fushën e rehabilitimit.

➤ TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

- **Programi i studimit:** Bachelor në “Shkenca të Rehabilitimit”
- **Cikli i studimit:** Cikli i parë
- **Kohëzgjatja:** 3 vite akademike / 6 semestra
- **Gjuha:** Shqip
- **Kredite:** 180 ECTS
- **Forma e studimit:** Me kohë të plotë
- **Emërtimi i diplomës:** “Shkenca të Rehabilitimit”
- **Departamenti përgjegjës:** Departamenti i Shkencave Biomjekësore dhe Humane

❖ ÇFARË DO TË STUDIOJNË STUDENTËT GJATË PROGRAMIT?

Programi është i strukturuar në mënyrë progresive, duke filluar me bazat e shkencave biomjekësore dhe të lëvizjes dhe duke vijuar me disiplinat profesionale të fizioterapisë dhe rehabilitimit. Studentët do të studiojnë strukturën dhe funksionimin e trupit të njeriut, patologjitë dhe problematikat funksionale, metodat e vlerësimit dhe trajtimit, si dhe parimet e rehabilitimit. Një pjesë e rëndësishme i kushtohet formimit praktik dhe klinik, përmes të cilit studentët zbatojnë njohuritë e fituara në situata reale profesionale. Programi përfshin gjithashtu shkencat humane, mjekësinë sportive, kërkimin shkencor dhe fusha bashkëkohore të rehabilitimit.

➤ **VITI I – BAZAT E SHKENCAVE TË REHABILITIMIT**

Semestri I

- **Lënda: MORFOLOGJI HUMANE — Module:** Anatomia e Njeriut • Neuroanatomy • Higjiena e Përgjithshme
- **Lënda: BIOLOGJI / BIOKIMI — Module:** Biologji e Përgjithshme dhe e Aplikuar • Biokimi dhe Biokimi Klinike • Gjenetikë Mjekësore
- **Lënda: SHKENCA EKZAKTE — Module:** Biomekanikë
- **Lënda: MJEKËSI FIZIKE, DIAGNOSTIKIM — Module:** Fiziologjia e Njeriut • Fiziologji e Ushtrimit
- **Lënda: GJUHË E HUAJ — Module:** Gjuhë Angleze

Semestri II

- **Lënda: MORFOLOGJI HUMANE — Module:** Anatomi Funksionale
- **Lënda: SHKENCA HUMANE DHE SOCIALE — Module:** Psikologjia e Përgjithshme dhe Klinike • Sociologji • Bioetikë dhe Legjislacion Mjekësor
- **Lënda: SHKENCA EKZAKTE — Module:** Biostatistikë • Informatikë
- **Lënda: MJEKËSI FIZIKE, DIAGNOSTIKIM — Module:** Kontrolli Mjekësor dhe Fizioterapeutik • Kineziologji
- **Lënda: GJUHË E HUAJ — Module:** Gjuhë Latine
- **Lënda: PRAKTIKË — Modul:** Praktikë 1

➤ **VITI II – FORMIMI PROFESIONAL DHE REHABILITIMI**

Semestri I

- **Lënda: FORMIM NDËRDISIPLINOR — Module:** Anatomi Imazherike • Farmakologji
- **Lënda: PATOLOGJI NË SPORT — Module:** Fiziologji Patologjike • Patologjitë Sportive • Sëmundjet e Brendshme
- **Lënda: PATOLOGJI SPECIFIKE — Module:** Geriatri • Reumatologji • Ortopedi • Traumatologji
- **Lënda: METODAT BAZË TË VLERËSIMIT DHE TRAJTIMIT NË FIZIOTERAPI — Modul:** Metodat Bazë të Vlerësimit dhe Trajtimit në Fizioterapi
- **Lënda: PRAKTIKË — Modul:** Praktikë 2

Semestri II

- **Lënda: METODAT BAZË TË VLERËSIMIT DHE TRAJTIMIT NË FIZIOTERAPI — Modul:** Metodat Bazë të Vlerësimit dhe Trajtimit në Fizioterapi
- **Lënda: MJEKËSI SPORTIVE — Module:** Rehabilitim Ushtrimor Kardiorespirator • Rehabilitim Ushtrimor Sportiv • Rehabilitim Ushtrimor në Reumatologji
- **Lënda: REHABILITIM I PËRGJITHSHËM — Module:** Rehabilitim i Aparatit Lokomotor • Rehabilitim në Geriatri • Elektroterapi
- **Lënda: PRAKTIKË — Modul:** Praktikë 2

➤ **VITI III – REHABILITIMI KLINIK DHE APLIKIMI PROFESIONAL**

Semestri I

- **Lënda: PATOLOGJI SPECIALITETESH** — **Module:** Neurologji • Pediatri
- **Lënda: FORMIM NDËRDISIPLINOR 2** — **Module:** Shëndet Publik dhe Metodologjia e Kërkimit Shkencor • Rehabilitim ORL dhe Maksilofacial
- **Lënda: MJEKËSI FIZIKE DHE REHABILITIM** — **Module:** Termo-Hidro-Klimatoterapi • Terapia Manuale • Masazh Sportiv • Teknika të Trajtimit në Fizioterapi • Terapi Okupacionale
- **Lënda: PRAKTIKË** — **Modul:** Praktikë 3

Semestri II

- **Lënda: FORMIM NDËRDISIPLINOR 2** — **Module:** Patologjitë Kirurgjikale dhe Onkologjike • Rehabilitim Onkologjik
- **Lënda: LËNDË ME ZGJEDHJE** — **Module:** Aquaterapi • Telerehabilitim • Edukim Fizik – Fitnes
- **Lënda: REHABILITIM USHTRIMOR SPECIFIK** — **Module:** Rehabilitim Ushtrimor në Kirurgji • Rehabilitim Ushtrimor në Neurologji • Rehabilitim Ushtrimor në Pediatri • Rehabilitim Ushtrimor Uro-Gjinekologjik dhe Obstetrik • Rehabilitim Prostetik
- **Lënda: PRAKTIKË** — **Modul:** Praktikë 3

✓ **Programi përmbyllet me Provimin e Përgjithshëm Përfundimtar.**

❖ PRAKTIKA PROFESIONALE DHE PËRVOJA KLINIKE

Praktika profesionale dhe klinike është pjesë e rëndësishme e programit dhe zhvillohet në mënyrë progresive gjatë tre viteve të studimit.

Për realizimin e praktikave, Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit bashkëpunon me institucione shëndetësore publike dhe private, klinika, qendra rehabilitimi dhe struktura të tjera të shërbimit shëndetësor, nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit.

Nëpërmjet praktikave, studentët zbatojnë njohuritë e fituara gjatë procesit mësimor në ambiente reale profesionale dhe klinike, duke u njohur me raste të ndryshme dhe me organizimin e procesit të rehabilitimit.

Praktikat zhvillohen nën orientimin dhe mbikëqyrjen e personelit përgjegjës dhe synojnë zhvillimin e aftësive profesionale, komunikimin me pacientët dhe bashkëpunimin me ekipin multidisciplinar.

Studentët zhvillojnë gjithashtu aktivitete praktike në laboratorët e Fakultetit, duke lidhur formimin akademik me përvojën praktike.

❖ STAFI AKADEMIK DHE ORGANIZIMI I PROCESIT MËSIMOR

Programi mbështetet nga një staf akademik i kualifikuar dhe me përvojë, me ekspertizë në fushat e shkencave biomjekësore, fizioterapisë, rehabilitimit, shkencave të lëvizjes dhe disiplinave të tjera të lidhura me programin.

Stafi akademik angazhohet në zhvillimin e procesit mësimor teorik, praktik dhe klinik, duke kontribuar në formimin akademik dhe profesional të studentëve.

Programi zhvillohet me kohë të plotë dhe procesi mësimor zhvillohet me prezencë fizike, sipas orarit dhe organizimit të përcaktuar nga Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit, nga e hëna deri të premten.

❖ DIPLOMA

Pas përmbushjes së të gjitha detyrimeve akademike të programit të studimit dhe përfundimit të Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar, studenti pajiset me Diplomën “Bachelor” në “Shkenca të Rehabilitimit”, së bashku me Suplementin e Diplomës dhe dokumentacionin përkatës akademik në gjuhën shqipe dhe angleze.

❖ PROFILI PROFESIONAL I TË DIPLOMUARIT

Programi Bachelor në “Shkenca të Rehabilitimit” përgatit të diplomuarin për ushtrimin e profesionit të **fizioterapistit**, me një formim të gjerë në fizioterapi dhe rehabilitim dhe me **orientim të veçantë në fushën e sportit dhe rehabilitimit sportiv**.

Formimi i marrë gjatë tre viteve të studimit i mundëson të diplomuarit të punojë me një gamë të gjerë problematikash dhe grupmoshash, duke përfshirë çrregullimet e aparatit lokomotor, patologjitë neurologjike, pediatrike, reumatologjike, geriatrike, post-kirurgjikale dhe problematika të tjera që kërkojnë ndërhyrje fizioterapeutike dhe rehabilituese.

Në të njëjtën kohë, programi ofron një **formim të avancuar dhe të orientuar drejt sportit**, përmes përfshirjes së lëndëve dhe moduleve si Patologjitë Sportive, Mjekësia Sportive, Rehabilitimi Ushtrimor Sportiv, Masazhi Sportiv, Fiziologjia e Ushtrimit, Biomekanika dhe Edukimi Fizik – Fitnes.

Kjo e bën të diplomuarin të aftë të zhvillojë veprimtari profesionale si **fizioterapist i përgjithshëm**, duke pasur një **profil të orientuar në fizioterapinë sportive dhe rehabilitimin e sportistëve**.

Dy dimensione të formimit profesional

- **Fizioterapi e përgjithshme:** vlerësim funksional, fizioterapi dhe rehabilitim për problematika të ndryshme muskuloskeletore, neurologjike, pediatrike, geriatrike, reumatologjike, post-kirurgjikale dhe të tjera.
- **Orientim në sport:** parandalimi dhe rehabilitimi i dëmtimeve sportive, rikthimi në aktivitet fizik dhe sport, rehabilitimi ushtrimor sportiv, masazhi sportiv, fiziologjia e ushtrimit, biomekanika dhe aplikimi i ushtrimeve në kontekstin sportiv.

Ku mund të ushtrojë profesionin i diplomuari?

I diplomuari mund të angazhohet si fizioterapist në struktura të ndryshme të kujdesit shëndetësor dhe rehabilitimit, si dhe në ambiente të lidhura me sportin, përfshirë:

- qendra fizioterapie dhe rehabilitimi;
- spitale dhe qendra shëndetësore;
- klinika dhe struktura private;
- qendra të mjekësisë sportive dhe rehabilitimit sportiv;
- klube dhe struktura sportive;

- ekipe dhe ambiente të përgatitjes fizike dhe sportive;
- institucione dhe struktura të tjera ku ofrohen shërbime fizioterapeutike dhe rehabilituese.

Në përfundim, profili i të diplomuarit mund të përmblihet si: Fizioterapist me formim të përgjithshëm dhe orientim/nën-specializim në sport dhe rehabilitim sportiv.

❖ **NJOHURITË DHE KOMPETENCAT E TË DIPLOMUARIT**

Në përfundim të programit, i diplomuari në “Shkenca të Rehabilitimit” ka fituar njohuri dhe kompetenca në shkencat biomjekësore, fizioterapi dhe rehabilitim.

I diplomuari është i përgatitur për të:

- vlerësuar gjendjen funksionale të individit;
- identifikuar nevojat rehabilituese;
- planifikuar dhe zbatuar programe rehabilitimi;
- përdorur metoda dhe teknika rehabilituese;
- hartuar dhe zbatuar programe ushtrimore;
- monitoruar ecurinë funksionale të pacientit;
- përshtatur ndërhyrjet rehabilituese sipas nevojave individuale;
- komunikuar në mënyrë profesionale me pacientin;
- bashkëpunuar me profesionistët e tjerë të ekipit multidisciplinar të kujdesit shëndetësor.

Të diplomuarit mund të angazhohen në:

- institucione shëndetësore publike dhe private;
- spitale dhe qendra shëndetësore;
- qendra fizioterapie dhe rehabilitimi;
- qendra të mjekësisë sportive dhe rehabilitimit sportiv;
- institucione dhe struktura të tjera ku ofrohen shërbime rehabilituese dhe fizioterapeutike.

❖ **MUNDËSITË PËR PUNËSIM DHE USHTRIMIN E PROFESIONIT**

Pas përfundimit të programit Bachelor në “Shkenca të Rehabilitimit”, studentët i nënshtrohen provimit të shtetit, sipas legjislacionit në fuqi. Pas përmbushjes së kërkesave ligjore dhe profesionale, përfshirë procedurat e regjistrimit përfshirë procedurat e regjistrimit dhe pajisjes me lejen përkatëse për ushtrimin e profesionit pranë Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë, **të diplomuarit mund të ushtrojnë profesionin e fizioterapistit, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 142, datë 06.03.2026, që ndryshon VKM nr. 649, datë 14.09.2011.**